

NEWSLETTER

Maj

ALBSIG
PJESË E  KASTRATI GROUP

**Albsig - një dritare mundësish
për të rinjtë në Panairin e
Punës dhe Karrierës 2024,
realizuar nga Fakulteti i
Biznesit, UAMD.**

**Albsig merr pjesë në “Panairin
e Karrierës & Punës” në
Kolegjin Universitar Qiriazi.**

**Z. Elton Korbi, zgjidhet me
detyrën e presidentit të
Shoqatës së Siguruesve të Jetës,
Pensioneve dhe Fondeve të
Investimeve.**

**Sigurimi i Përgjegjësisë
Civile për Enët në presion
në Albsig.**



PJESË E  KASTRATI GROUP

Shoqëria e Sigurimit Albsig sh.a., pjesë e Grupit KASTRATI, ushtron aktivitet të suksesshëm që nga viti 2004, në cilësinë e siguruesit të Jo - Jetës. Me një rrjet me 28 degë, Albsig mbulon territorin e Republikës së Shqipërisë. Albsig mbështetet në stafin e dedikuar dhe profesional dhe ofron shërbim të shpejtë dhe cilësor.

VIZIONI

Klienti, prioriteti ynë. Ne tejkalojmë pritshmëritë e tij përmes shërbimit, integritetit dhe profesionalizmit.

MISIONI

Të jemi zgjedhja e parë e çdo klienti. Ne rritemi bashkë me klientët tanë.

FILOZOFIA

Besim dhe solidaritet me klientët për të arritur suksesin e përbashkët.



Partneri juaj i sigurtë!



PJESË E  KASTRATI GROUP





Albsig - një dritare mundësish për të rinjtë në Panairin e Punës dhe Karrierës 2024, realizuar nga Fakulteti i Biznesit, UAMD.

"Panairi i Punës dhe Karrierës 2024" në Fakultetin e Biznesit pranë Universitetit "Aleksandër Moisiu" erdhi edhe këtë vit si mundësi e shkëlqyer e studentëve të këtij institucioni arsimor. Shoqëria e Sigurimeve Albsig pjesë e Kastrati group, në një stendë moderne, e cila ishte ideuar dhe dizajnuar me frymën moderne të komunikimit vizual, mirëpriti të gjithë studentët e interesuar të bëhen pjesë e Albsig. Albsig ka qenë dhe do të mbetet promotore e brezave të rinj përfshirë studentë e të rinjë që morën pjesë në panair. Stenda e Albsig mirëpriti një numër të konsiderueshëm studentësh, e të rinjsh të cilët, shprehën dëshirën të bëhen pjesë e stafit të Albsig. Por kishte dhe nga ata studentë që dakortësuan që të zhvillojnë dhe internshipet e kërkuara nga kurrikulat shkollore. Albsig numëron një listë të konsiderueshëm të studentëve që nëpërmjet panairove dhe work-shopeve janë bërë pjesë e stafit të kompanisë.

Panairi i Punës dhe Karrierës 2024, ky aktivitet vjetor, i cili mbajti edicionin e tij të katërt, synoi të ndërtojë ura lidhëse mes studentëve dhe tregut të punës, duke sjellë së bashku institucionet shtetërore, sipërmarrjen private dhe talentet e reja. Dekani i Fakultetit të Biznesit, Prof. Dr. Shkëlqim Fortuzi, në fjalën e tij përshëndetëse, theksoi rëndësinë e përshtatjes së kurrikulave akademike me nevojat e vazhdueshme të tregut të punës. Gjithashtu, Fortuzi vlerësoi rolin e panairit në ofrimin e mundësive të praktikave profesionale dhe punësimit për të rinjtë. Panairi u nderua me pjesëmarrjen e personaliteteve të shquara si znj. Ogerta Manastirliu, Ministre e Arsimit dhe Sportit, znj. Emiriana Sako, Kryetare e Bashkisë Durrës, si dhe përfaqësues të biznesit dhe akademisë.

Panairi ofroi mundësi të shumta për studentët përmes 160 bizneseve të pranishme përfshirë dhe Albsig të cilët hapën dyert për trajnime, praktika dhe mundësi punësimi. Rreth **300 aplikime për punë** u dorëzuan dhe u lidhën **50 kontrata pune** për pozicione part-time. Gjithashtu, u shpërndanë **9 bursa studimi** në fushën e hotelërisë dhe turizmit, duke dëshmuar angazhimin e Fakultetit për të mbështetur arsimimin dhe karrierën e studentëve. Ky panair tashmë është bërë një traditë që premtan të rrisë ndikimin dhe të ndërtojë më shumë ura midis akademisë dhe tregut të punës, duke siguruar që studentët të jenë gati për sfidat e ardhshme profesionale.



Albsig merr pjesë në “Panairin e Karrierës & Punës” në Kolegjin Universitar Qiriazhi.



“PANAIRI I KARRIERËS & PUNËS” ishte një ndër eventet e zhvilluara nga Kolegji Universitar Qiriazhi. Në event studentët ju dha mundësia të lidhen me kompanitë më të mira në vend dhe të eksploronin mundësitë interesante të punësimit. Studentët do të kenë mundësi të realizojnë praktika/internship, por edhe punë të përkohshme ose pozicione me kohë të plotë.

“PANAIRI I KARRIERËS & PUNËS” është panairi i zhvilluar për të tretin vit rradhazi nga Kolegji Universitar Qiriazhi. Në këtë event ka marrë pjesë edhe Albsig, pjesë e Kastrati group. Si një ndër kompanitë serioze dhe të përkushtuara pas studentëve, Albsig ka spikatur me stendën e saj moderne dhe të dizajnuar me delikatesë për t’ju ardhur në ndihmë çdo studenti me informacionet e duhura. Sipas organizatorëve qëllimi i këtij panairi është bashkëpunimi mes komunitetit të biznesit dhe studentëve, duke theksuar faktin se Fakulteti i Ekonomisë si institucion ka për detyrë përveç formimit akademik, të kontribuojë edhe në atë profesional. Kolegji Universitar Qiriazhi vazhdon të jetë mbështetës i përhershëm për fillimin e karrierës së studentëve gjatë gjithë rrugëtimit të tyre akademik.

Organizatorët theksuan se: realizimi i këtij eventi bëri të mundur lidhjen me biznese të rëndësishme. Në këtë panair, do të keni mundësinë të takoni përfaqësues të kompanive më të njohura dhe të bëni njohje të rëndësishme për të ardhmen tuaj. **Mundësi Punësimi:** Kompanitë janë në kërkim të talenteve dhe rekrutimeve të reja! Duke marrë pjesë, ju krijoni rastin për të aplikuar për praktika, punë të përkohshme ose pozicione me kohë të plotë. Duke qenë pjesë e këtij event, ju tregoni përkushtimin tuaj ndaj zhvillimit të karrierës dhe vëmendjen tuaj ndaj rritjes personale dhe profesionale. Në këtë panair, ishin të pranishëm mbi 35 kompani serioze dhe prestigjoze, ku studentët e të gjitha programeve të studimit në Universitetin Qiriazhi patën mundësi të njihen me mundësitë dhe të aplikonin në vendet vakante, si nevojë e kërkesë-ofertës në tregun e punës.



Z.Elton Korbi, zgjidhet me detyrën e presidentit të Shoqatës së Siguruesve të Jetës, Pensioneve dhe Fondeve të Investimeve.

Zgjidhet drejtuesi i ri nga Asambleja e Përgjithshme e Shoqatës së Siguruesve të Jetës, Pensioneve dhe Fondeve të Investimeve. Mbështetur në rezultatet e votimit, që prej datës 7 prill, me detyrën e Presidentit të Shoqatës është zgjedhur në mënyrë unanime z.Elton Korbi.

Elton Korbi që prej vitit 2019 është Administrator i Përgjithshëm i Shoqërisë Administruese të Fondeve të Pensionit dhe Fondeve të Investimit, Albsig Invest. Ai ka një eksperiencë të gjatë në sektorin bankar, fillimisht në Bankën Kombëtare të Greqisë dhe më tej në Bankën e Shqipërisë.

Z. Elton Korbi u zgjodh edhe President i Shoqatës së Siguruesve të Jetës, Pensioneve dhe Fondeve të Investimeve (SHSJPI) ku në këtë rol do të përfaqësojë zërin e anëtarëve për çështjet e ndërgjegjësimit dhe promovimit të interesit më të mirë të SHSJPI-së dhe anëtarëve të saj.

Z. Elton Korbi është ekspert në sektorin bankar ku ka punuar prej shumë vitesh në Bankën e Shqipërisë dhe atë Kombëtare të Greqisë. Sic e përmendëm dhe më lartë aktualisht z. Korbi është Administrator i Përgjithshëm i Shoqërisë Administruese të Fondeve të Pensionit dhe Fondeve të Investimit Albsig Invest.





Sigurimi i Përgjegjësisë Civile për Enët në presion në Albsig.

Bëni Sigurimin e Përgjegjësisë Civile për Enët në presion në Albsig, shmangni rreziqet dhe fitoni sigurinë për mbrojtje në industrinë e hotelerisë, restoranteve, klinikave mjekësore dhe linjave të prodhimit.

Siguria dhe shëndeti në punë janë pjesë përbërëse e procesit të punës dhe në përgjithësi janë elemente kyçe të cilësisë së punës. Për një sezon turistik të mbarë dhe për një siguri me shumë, Albsig u bën thirrje të gjithë bizneseve si: Hotele, Restorante, Klinika Mjekësore, Linja prodhimi dhe Kaldajat që të bëjnë të mundur sigurimin e duhur me partnerin e sigurtë në këtë fushë që kryeson tregun siç është vetëm Albsig.



Çfarë është Sigurimi i përgjegjësisë Civile për Enët në presion?

Sigurimi i përgjegjësisë civile për enët në presion mbulon dëmet e mundshme që mund të shkaktohen nga defektet apo aksidentet e enëve në presion. Ky sigurim është thelbësor për mbrojtjen e bizneseve nga kërkesa për dëmshpërblim që mund të vijnë si pasojë e aksidenteve.

Kush ka nevojë për këtë sigurim?

1. Hotelet
2. Restorantet
3. Klinikat Mjekësore
4. Linjat e Prodhimit
5. Kaldajat dhe sistemet e ngrohjes industriale.

Nëse një biznes është pajisur me sigurim ai përfiton:

- Mbrojtje financiare - Ky sigurim mbulon kostot e dëmeve ndaj palëve të treta në rast aksidentesh.
- Siguri për Stafin dhe Konsumatorët - Siguron një mjedis më të sigurtë për stafin dhe klientët.
- Përputhje Ligjore - Ndihmon në përmbushjen e kërkesave ligjore dhe rregullative.
- Besueshmëri - Përmirëson besueshmërinë dhe reputacionin e biznesit Tuaj e sidomos duke e siguruar atë në Albsig pasi vetëm Albsig është një ndër kompanitë e sigurimeve që jo vetëm në rast aksidenti por edhe në rastin e tërmetejeve ka dëmshpërblyer klientat e saj në kohë record.

Çfarë mbulon ky sigurim?

- Dëmet ndaj pasurisë - Dëmet ndaj pronave të palëve të treta për shkak të shpërthimeve apo aksidenteve.
- Humbje financiare - Humbjet financiare që mund të pësojnë palët e treta si pasojë e aksidentit.
- Lëndime personale - Kostot mjekësore dhe dëmshpërblimet për lëndimet personale ndaj palëve të treta.

Ja hapat me të cilat ju udhëzon Albsig për ta siguruar këtë mbulim:

- Vlerësimi i rrezikut – Konsultohuni me një ekspert sigurimesh në Albsig dhe merr menjëherë vlerësimin paraprak të rreziqeve specifike që mund t'i kanosen biznesit tuaj.
- Zgjedhja e Policës së duhur – Zgjidhni një policë sigurimi që l përshtatet nevojave dhe madhësisë së biznesit tuaj.
- Monitorim dhe Mirëmbajtje – Kryeni inspektime dhe mirëmbajtje të rregullta të enëve në presion për të minimizuar rreziqet.
- Trajnim Personeli – Trajnoni personelin tuaj për përdorimin dhe mirëmbajtjen e sigurt të enëve në presion.

Pse është e rëndësishme që çdo biznes të pajiset me sigurimin e përgjegjësisë civile për enët në presion në Albsig?

1. Për shkak të rrezikut të lartë që paraqesin enët në presion, një aksident mund të ketë pasoja të rënda financiare dhe ligjore për biznesin tuaj. Sigurimi i Përgjegjësisë Civile ofron një mburojë kritike kundër këtyre rreziqeve.
2. Kontaktoni menjëherë me një ekspert sigurimesh në Albsig në numrin 0682052744 për të mësuar më shumë rreth opsioneve të sigurimit për enët në prsion dhe për të mbrojtur biznesin Tuaj nga rreziqet e mundshme.
3. Nëse keni nevojë për më shumë informacion ose keni ndonjë pyetje mos hezitoni të na kontaktoni dhe të na shkruani në adresën e email-it: info@albsig.al. Albsig është gjithmonë pranë jush për të ndihmuar biznesin tuaj të jetë i sigurt dhe i mbrojtur në çdo moment.




Vendimi - Kush përdor bombola gazi e ka të detyrueshëm sigurimin.

Kush përdor bombola gazi për aktivitetin e tij, do të duhet të bëjë sigurimin e detyrueshëm. Vendimi i Këshillit të Ministrave ka marrë fuqi ligjore dhe parashikon që restorantet, hotelet, kompanitë e ndërtimit e prodhimit, si dhe institucionet shtetërore që përdorin kaldaja, bombula gazi apo pajisje nën presion, do të jenë të detyruara të bëjnë sigurimin, mbi bazën e nivelit të riskut që kategorizohen pajisjet që ato përdorin. Kontratat që do të duhen që ato të lidhin me kompanitë e sigurimit, duhet të parashikojnë rastet e rreziqeve që mund të shkaktojnë këto pajisje.

Kështu, për pajisje apo impiante nën presion me rrezik të ulët, kufiri minimal është 10 milionë lekë për ngjarje sigurimi dhe 20 milionë lekë në agregat, ndërsa për pajisje me rrezik të mesëm 20 milionë lekë për ngjarje sigurimi dhe 40 milionë lekë në agregat. Po ashtu, vendimi i qeverisë përcakton për impiantet me rrezik të lartë, kufiri minimal do të jetë 35 milionë lekë për ngjarje sigurimi dhe 70 milionë lekë në agregat dhe ato me rrezik shumë të lartë, 50 milionë lekë për ngjarje sigurimi dhe 100 milionë lekë në agregat.

Kjo policë është e detyrueshme dhe subjekt kontrolli ISHTI dhe duhet ta ketë çdo subjekt që ka enë nën presion.



 +355 (0) 42254770 / 764

 info@albsig.al

WWW.ALBSIG.AL